



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.125/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bojan Sekulic, nga Organizata Joqeveritare Centre for Social Inclusion Gracanica (CSIG), paraqitur kundër Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2676-2025, të datës 06.10.2025, me të cilin iu refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 10.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa ZL.Anr.125/2025 e datës 07.10.2025, e parashtruar nga Bojan Sekulic nga Organizata Joqeveritare Centre for Social Inclusion Gracanica (CSIG), e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2676-2025, i datës 06.10.2025, për shkak të mos akreditimit të Organizatës Joqeveritare Centre for Social Inclusion Gracanica (CSIG), për vëzhgim në Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më 07.10.2025, Bojan Sekulic, nga Organizata Joqeveritare Centre for Social Inclusion Gracanica (CSIG), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se e njëjta përmes email ka pranuar Vendimin Nr. 01/2676-2025, nga Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, me të cilin iu refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, për arsye se në statutin e dorëzuar në ZRCKF, për akreditim të organizatës si aktivitet citohet "Vëzhgimi i procesit zgjedhor", ndërsa e njëjta gjë nuk gjendet në versionin origjinal të statutit i cili është marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë verifikimit.

Sipas parashtruesit të ankesës, gjatë paraqitjes së kërkesës për akreditim në ZRCKF, në mënyrë elektronike, gabimisht dorëzoi një version pune të statutit i cili është në proces ndryshimi dhe ende nuk i është paraqitur ministrisë kompetente për miratim të ndryshimeve dhe plotësimeve të statutit. OJQ CSIG, për shumë vite është e përfshirë në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, në ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të qenë socialisht aktivë dhe përgjegjës përmes realizimit të projekteve të ndryshme, si dhe përmes avokatisë, lobimit dhe anti-korrupsionit. E njëjta, që nga viti 2017, ka marrë pjesë në një numër të madh procesesh zgjedhore përmes angazhimit të vëzhguesve si në zgjedhjet lokale ashtu edhe në ato parlamentare, ku ka kryer me sukses të gjitha aktivitetet, pa ndonjë vërejtje për punën e saj nga

asnjë palë. Në vitin 2021, organizata CSIG, ka pasur anëtar në Komisionin Komunal Zgjedhor dhe njëkohësisht ka pasur edhe keshillin e vendvotimit (KVV) dhe në bashkëpunim me Komisionin Komunal Zgjedhor, i ka kryer të gjitha detyrat në përputhje me ligjin.

Më tej në ankesë theksohet se drejtori i OJQ-së, së lartëcekur ka 15 vjet përvojë në realizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor. Prandaj, mendojnë se për shkak të një gabimi teknik në dorëzimin e Statutit, vendimi për refuzimin e akreditimit është i pabazuar dhe mendon se PZAP, do ta shqyrtojë hollësisht këtë ankesë dhe do të vendosë në favor të organizatës CSIG dhe do të miratojë akreditimet për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

Bashkangjitur në ankesë, si provë ka paraqitur Statutin original, si dhe dokumentacionin tjetër me të cilin dëshmon faktet e paraqitura për pjesëmarrjen në proceset e mëparshme zgjedhore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në njoftimin e dërguar në PZAP ka sqaruar se në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, më saktësisht paragrafi 1 i nenit 54, ku theksohet se subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje. Në kategorinë e organizatave joqeveritare vendore me rastin e aplikimit për akreditim, në përputhje me Rregulloren 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, kërkojnë dokumentet si në vijim: formulari i aplikimit për akreditim të OJQ të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara, listën e vëzhguesve të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara, Certifikatën e regjistrimit të OJQ.

Të gjitha këto dokumente verifikohen nga ZRCKF, e cila më pas i rekomandon KQZ-së, për ose kundër akreditimit të OJQ, që ka aplikuar.

Më tej në përgjigje KQZ thekson se OJQ-Center for Social Inclusion-CSIG, ka aplikuar përmes platformës elektronike për akreditim të tridhjetë e gjashtë (36) vëzhguesve për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në platformë, kjo organizatë është regjistruar si OJQ, me datën 21 shtator 2015 dhe se në Statutin e tyre tek neni 3, në mes tjerash përfshinë edhe vëzhgimi i proceseve zgjedhore.

Në takim të KQZ-së, është kërkuar nga Zyra, të bëjë verifikimin e detajuar e organizatave jo qeveritare që kanë aplikuar për akreditim në Zgjedhjet Lokale 2025. Për të bërë verifikimin e detajuar të kërkuar nga KQZ, Zyra ka kontaktuar Departamentin e OJQ në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në lidhje me dokumentacionin e kësaj organizate të cilat janë të deponuara në këtë departament.

Pas pranimit të materialeve nga DOJQ, Zyra ka vlerësuar dokumentacionin dhe ka vërejtur që sipas statutit të dorëzuar në Departamentin e OJQ në MPB, kjo organizatë nuk ka fushëveprim të drejtat e njeriut dhe zgjedhjet. Ndërsa, në statutin që e ka dërguar me rastin e aplikimit për akreditim, në fushëveprim ka edhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore. Së fundi Statuti i dorëzuar në Departamentin e OJQ dhe statuti i bashkangjitur me rastin e aplikimit për akreditim, në ZRCKF, mbajnë të njëjtën datë të regjistrimit 08.06.2015, ndërsa ndryshimet në këto statute të të njëjtës datë ekzistojnë në Nenin 3 të Statutit që ka të bëjë me qëllimin e organizatës.

Nisur nga çfarë u tha më lartë, Zyra i ka rekomanduar KQZ-së, për refuzimin e akreditimit të tridhjet e gjashtë (36) vëzhguesve të OJQ Center for social Inclusion-CSIG, dhe se në takimin e mbajtur më 6 tetor 2025, KQZ ka marrë vendim për refuzimin e akreditimit të vëzhguesve të kësaj organizate, sipas rekomandimit të Zyrës,

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli vlerëson se, në bazë të shkresave të lëndës rezulton se Organizata Joqeveritare Centre for Social Inclusion Gracanica (CSIG), ka përfunduar aplikimin për akreditim si vëzhgues në Zyrën për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025. Ndërsa Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, me datë 06.10.2025 ka nxjerr rekomandim, me të cilin ka rekomanduar që OJQ Center for social Inclusion-CSIG, së bashku me tridhjet e gjashtë (36) vëzhguesit e saj të refuzohet për shkak se nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu akredituar për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.10.2025, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, për refuzimin e akreditimit të OJQ Center for social Inclusion-CSIG, së bashku me tridhjet e gjashtë (36) vëzhguesit e saj, për arsye të ndryshimit të Nenit 3 të statutit të OJQ-së, që ka të bëjë me qëllimin e organizatës.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, njoftimit të KQZ-së, vendimin e KQZ-së të datës 06.10.2025 me numër protokolli 01/2676-2025, e konsideroi të drejtë dhe të ligjshëm pasi që i njëjti është i bazuar në dispozitat ligjore që i referohen akreditimit të vëzhguesve konkretisht nenit 54 të LZP-së, dhe Rregullores 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve të cilat përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e akreditimit të vëzhguesve të OJQ-ve, që dëshirojnë të marrin pjesë në vëzhgimin e zgjedhjeve.

Me dispozitën e nenit 54 të LZP-së përkatësisht paragrafi 1. *“Subjektet politike të certifikuar, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje”.*

Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, përkatësisht në nenin 1.1. parasheh se *“OJQ që në fushëveprimin e tyre merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të vëzhgojnë procesin zgjedhor”.*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se OJQ CSIG ka aplikuar për akreditim për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale, të 12 Tetorit 2025, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të lartëcekura, mirëpo e njëjta në statutin e saj përkatësisht nenin 3 që ka të bëjë me fushëveprimin e OJQ-së, nuk e ka të përcaktuar si qëllim edhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore. PZAP, konsideron se një OJQ nuk është e përshtatshme për të qenë pjesë e listës së organizatave për vëzhgim të zgjedhjeve nëse fushëveprimi i saj nuk mbështetet në kriteret ligjore që janë përcaktuar me LZP dhe rregulla zgjedhore. Ndërsa në këtë rast nga shkresat e lëndës dhe

përgjigjes së KQZ-së rezulton se OJQ CSIG, e cila ka bërë verifikimin e detajuar të dokumentacionit të kërkuar nga Departamenti i OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Zyra ka vlerësuar dokumentacionin dhe ka vërejtur që sipas statutit të dorëzuar në Departamentin e OJQ në MPB, kjo organizatë nuk ka fushëveprim të drejtat e njeriut dhe zgjedhjet. Ndërsa, në statutin që e ka dërguar me rastin e aplikimit për akreditim, në fushëveprim ka edhe vëzhginin e proceseve zgjedhore. Një gjë të tillë e kishte pranuar edhe vet parashtruesi i ankesës se kishte ndrruar nenin 3 të Statutit të OJQ-së, mirëpo ende nuk e deponuar në Departamentin e OJQ-ve në MPB.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 54 nenit 115 par. 1 lidhur më nenin 118 par. 1 dhe 5 të dhe 119 LZP-së, dhe nenit 13.2 të Rregullore Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.A.nr.125/2025, datë: 10.10.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.